



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:267989

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05795094

**C.nr.1242/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Selajdin Gallapeni dhe pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Labinot Demiraj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.G nga S, të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari Xh. B, avokat nga P, kundër të paditurës K e S – D e A, të cilën e përfaqëson sipas akt emërimit përfaqësuesi ligjor A. B nga S, për shkak të kompensimit mbi bazën e kualifikimit, / licencimit dhe inflacionit në pagë me datë 06.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**- Pa Shqyrtim Kryesor të çështjes -**

**I.** APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit N.G nga S, ashtu që DETYROHET e paditura K e S, D e A në S, që paditësit t'ia paguaj shumat si në vijim:

- Në emër të gradimit/licencimit, nga data 30.11.2018 e deri më datë 21.11.2022, për (47 muaj e 21 ditë), shumën prej 2.640.19 euro;
- Në emër të përfshirjes së inflacionit në pagë, nga data 01.12.2020 e deri më 21.11.2022, shumën prej 695.14 euro.

Që të gjitha këto shuma si në pikën I të dispozitivit, me kamatë ligjore prej 8%, ku kamata fillon të rrjedh sa i përket kompensimit në emër të gradimit, nga data e parashtrimit të padisë (30.11.2021), ndërsa në lidhje me përfshirjen e inflacionit në pagë, kamata fillon të rrjedh nga data e precizimit të kërkesëpadisë (29.12.2023), e deri në përmbushjen përfundimtare, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.

**II.** REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë lidhur me diferencën në pagë për kualifikim sa i përket periudhës kohore prej datës 18.04.2017 e deri më 29.11.2018, si dhe përfshirjes së inflacionit në pagë prej datës 18.04.2017 e deri më 30.11.2020, për shkak të parashkrimit të kërkesave.

**III.** DETYROHET e paditura K e S, që t'ia kompenson paditësit shpenzimet e procedurës, në vlerë prej 125.00 (njëqind e njëzet e pesë) euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër përtej shumës së aprovuar në lidhje me shpenzimet si në këtë pikë të dispozitivit, REFUZOHET.

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes të autorizuarit të saj Av. Xh. B, ka parashtruar padi më 30.11.2021 pranë kësaj gjykatë kundër të paditurës K e S– D e A, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shtesave në pagë mbi bazën e kualifikimit – licencimit për shkak se e paditura K e S, nuk ka vepruar konform Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, i njëjti ka shtuar se i jemi drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e kësaj forme të shtesës në pagë dhe tani e paditura e ka refuzuar kërkesën edhe pse praktika gjyqësore po e aprovon këtë formë të kompensimit.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 29.11.2023, ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin objektiv si dhe precizimin e kërkesëpadisë, ku për paditësin sipas kësaj parashtrëse ka kërkuar edhe kompensimin e inflacionit në pagë për vitet 18.04.2017 e deri me datë 21.11.2022, gjersa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë, 104.00 për hartimin e padisë, 21.00 për pagesën e taksës gjyqësore për padi, si dhe 104.00 për precizimin e kërkesëpadisë dhe shpenzimeve tjera nëse bëhen.

E paditura K e S – DKA, përmes të autorizuarit të saj theksuar se sa i përket kërkesës për kompensim e kualifikimit arsimor – avancimit në karrierë e kundërshtojmë në tërësi si të pabazuar për shkak se në rastin konkret paditësi ka nënshkruar një kontratë të punës ku janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e në mesin e tyre edhe paga, duke llogaritur edhe gradimin në shumën e caktuar si në kontratën bazë. Po ashtu ka theksuar se paditësit nuk kanë licencë valide dhe gjithashtu është thirrur në institutin e parashkrimit, përkatësisht në nenin 87 të Ligjit të punës, prandaj në fund ka theksuar se i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e gjykatës të e refuzoj si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, precizimit të kërkesëpadisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitura nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është **pjesërisht e themeltë**, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë pjesërisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes kontratën e punës me nr.234 të datës 04.11.2024, nga e cila gjykata vërtetoi faktin se paditësi është në marrëdhënie kontraktuale me të paditurën në cilësi të mësimdhënësit lëndor, si dhe i njëjti ka të përfunduar Fakultetin e Historisë dhe punon në SHFMU “Shkëndija”.

Kontestuese në mes të palëve ishte nëse paditësi është kompensuar në tërësi në emër të licencimit dhe i njëjti është i pajisur me licence valide.

Faktin se paditësi është i pajisur me licencë të rregullt të mësimdhënësit, gjykata e ka vërtetuar nga licenca e mësimdhënësit me nr.100012211, ku është vërtetuar se paditësi është i pajisur me licencë të rregullt karriere që nga data e lëshimit 01.03.2013.

Ndërsa faktin nëse paditësi është kompensuar në emër të gradimit, gjykata e ka vërtetuar nga kontrata e mësimdhënësit me nr. 234, e datës 04.11.2015 si dhe nga lista e pagave, ku gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi është kompensuar pjesërisht në emër të gradimit, në shumën prej 58.32 për çdo muaj, për çka tani në këtë çështje vendosi që t’ia aprovoj diferencën e papaguar,

pra shumë prej 55.35, ku kjo shumë i është llogaritur me muajt për të cilën gjykata ka vendosur, si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në lidhje me përfshirjen e inflacionit në pagë, gjykata bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit, paditësit ia ka njohur të drejtën e përfshirjes së inflacionit në pagë, duke ia llogaritur pagën bazë të paditësit, shumëzuar për përqindjen e inflacionit nder vite, ku si kriter ka marr pasqyrën nga Enti i Statistikave të Kosovës, duke arritur kështu në pjesën aprovuese, si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në bazë të Vendimit Nr.01/33, datë 29.08.2008, gjykata gjeti së Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2008, ka marrë vendim, ku sipas pikës 3 të këtij vendimi përcaktohet se “ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillorë dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”.

Ndërsa në pikën 4 theksohet se, citojmë: *Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët), dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur:*

- 1) *Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10 %;*
- 2) *Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19 %;*
- 3) *Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 %;*
- 4) *Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë), përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.*

Gjykata deri te shuma aprovuese për gradim erdhi duke ia shumëzuar pagën bazë të paditësit me 27 % për shkak se ka përfunduar studimet bachelor, shuma të cilën e ka siguruar në bazë të gradimit, duke arritur te periudha aprovuese më saktësisht sipas kësaj formule: (paga bazë 421.00 euro x 27% = 113.67 euro – 58.32 të cilat i ka siguruar paditësi gjatë marrëdhënies së punës = 55.35 euro diferenca e papaguar x 47 muaj e 21 ditë për të cilët i takon të i njihet diferenca e papaguar = 2.640.19 euro)

Ndërsa sa i përket pjesës aprovuese lidhur me shpërblimin e inflacionit në pagë gjykata është bazuar në mendimin juridik të miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023 në cilin parashihet se “*Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit, marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit Sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës*”, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”.

Pra bazuar nga kjo gjykata ia llogariti paditësit pagën bazë me përqindjen për secilin vit, si në periudhën aprovuese në pikën një dhe nga shuma e mbetur i shumëzohej me diferencën e papaguar duke arritur në shumën përfundimtare.

Gjykata vendosi si në pikën e dytë të dispozitivit të këtij aktgjykimi që për periudhat e lartcekura si në dispozitivin t’i refuzoj si të parashkruara për arsye se Komuna e Suharekës – Drejtoria e Arsimit me anë të përgjigjes në padi është thirrur në parashkrim të kërkesës duke u bazuar në nenin 87 të ligjit të punës, i cili thotë se citojmë, “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.*”.

Gjykata pas analizimit të padisë dhe përgjigjes në padi vërtetoi faktin se për periudhën 18.04.2017 e deri më 29.11.2018, sa i përket kompensimit në emër të gradimit kemi të bëjmë me

parashkrim të kërkesës për faktin se padia është paraqitur me datë 30.11.2021, e që i bie se nëse kthemi tre vite mbrapa atëherë periudha aprovuese përfshinë pjesën nga data 30.11.2018, ndërsa pjesa tjetër duhet të refuzohet për shkak se ka arritur afatin e parashkrimit.

Sa i përket pjesës së shpërblimit të inflacionit në pagë, gjykata po ashtu konstaton se pretendimet e palës së paditur qëndrojnë dhe janë të bazuar, për faktin se edhe në lidhje me këtë kërkesëpadi ka parashkrim të kërkesës, gjegjësisht për periudhën 18.04.2017 e deri më 30.11.2020 për faktin se precizimi i kërkesëpadi në aspektin objektiv me të cilin është futur edhe kërkesa për shpërblimin e inflacionit në pagë është bërë me datë 29.11.2023 që i bie se nëse kthehemi tre vite mbrapa atëherë përdurja aprovuese përfshinë pjesën prej datës 01.12.2020 e deri më 21.11.2022, pra deri kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit. Në lidhje me vendosjen për parashkrim të kërkesave, gjykata bazën ligjore e gjen në Ligjin e Punës, gjegjësisht në nenin 87 të këtij ligji në të cilin thuhet se citojmë, “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.*”.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 382 të LMD-së, sipas të cilës dispozitë është paraparë së *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*, dhe si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën paraqitjes së padisë në emër të gradimi, ndërsa në emër të inflacionit në pagë ka caktuar datën e precizimit të kërkesëpadi, gjegjësisht zgjerimit të padisë edhe në lidhje me përfshirjen e inflacionit në pagë.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë, shumë prej 104.00 euro, për taksë gjyqësore për padi, shumë prej 21.00 euro, (sipas tarifës së Odës së Avokatëve) në shumë të përgjithshme prej 125.00 euro. Ndërsa gjykata e refuzoi pjesën tjetër në lidhje me shpenzimet, pra shumë prej 104.00 për precizim të kërkesëpadi për faktin se i njëjti precizim, është bërë pa kërkesën e gjykatës.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat e në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2021:267989, 07.06.2024**

**G j y q t a r i**

**Selajdin Gallapeni**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.